# MISIONI SHQIPTAR

## E Lumja Nënë Tereza

**Blessed Mother Teresa Albanian Mission**
**739 Browns Line, Etobicoke, Ontario M8W 3V7**
**Tel. 416 503 4509** dhe **647 558 9382**
**www.misionineneteteza.com**

**Çdo të dielë në orën 12:30** Rruzarja dhe Mesha Shenjte

# KTHEHUNI

## 22 JANAR 2017




Kur Jezusi e mori vesh se e kishin burgosur Gjonin, u tërhoq në Galile. E lëshoi Nazaretin e shkoi e u vendos me banim në Kafarnaum, qytet bregdetar në krahinën e fisit të Zabulonit e të Neftalit, që të shkonte në vend fjala që tha Isaia profet: "Tokë e Zabulonit e tokë e Neftalit, në drejtim të detit, përtej Jordanit, Galileja paganë, populli që gjendej në errësirë pa një dritë të madhe; atyre që banonin në krahinën e hijes së vdekjes u lindi drita". Qysh atëherë Jezusi filloi të predikojë: "Kthehuni, se Mbretëria e Hyjit është ngjat!" Ndërsa Jezusi po ecte përngjat Detit të Galilesë, pa dy vëllezër: Simonin që quhet Pjetër dhe Andreun, të vëllanë e tij, duke hedhur rrjetën në det; ishin peshkatarë. E u tha: "Ejani mbas meje e unë do t'ju bëj peshkatarë njerëzish!" Ata menjëherë lanë rrjetat e shkuan pas tij. Duke vazhduar rrugën mëtej, pa dy vëllezër të tjerë, Jakobin e Zebedeut dhe Gjonin, vëllanë e tij, në lundër bashkë me Zebedeun, atin e tyre, duke ndrequr rrjetat, dhe i thirri. Ata aty për aty lanë lundrën dhe babën e shkuan pas tij. Jezusi shkonte prej një vendi në një tjetër nëpër mbarë Galilenë, duke mësuar në sinagogat e tyre, duke predikuar Ungjillin e Mbretërisë e duke shëruar në popull çdo sëmundje e çdo lëngatë. *Mt 4, 12-23*

## Mesha Shenjte....

Mesha kremtohet çdo të dielë në orën 12:30 PM te Kisha: Our Lady of the Miraculous Medal, **739 BROWN'S LINE, Etobicoke**, M8W 3V7 (Browns Line & Evans Avenue) Phone (416) 255-2721. Kisha ndodhet menjehere mbrapa Slovenia Credit Union. Public transport: Brown's Line at Coules Court North Farside (15 m N) 123. Per me shume informacion shih faqen internet: **www.ourladyofmm.com**

## Kalendari liturgjik…

24 Janar Shen Françesku i Salesit
25 Janar Kthimi I Shen Palit apostull
26 Janar Shen Timoteu dhe Titi
27 Janar Shen Angjela Meriçi
28 Janar Shen Tomë Akuini

## Haku Kishes 2016… E kane dhene:

| | |
|---|---|
| Aleks | Dragu |
| Aleks | Coku |
| Aleksander | Zefi |
| Aleksander | Agraja |
| Alfred | Shllaku |
| Altin | Miri |
| Anesti | Shyti |
| Anton | Tinaj |
| Anton | Malaj |
| Anton | Brunga |
| Arben | Toma |
| Arben | Pepa |
| Arben | Therqaj |
| Ardian | Precetaj |
| Artan | Vuksani |
| Artur | Haxhia |
| Astrit | Simeqi |
| Balto | Simoni |
| Beniamin | Hasko |
| David | Shtjefhilaj |
| Dede | Ukaj |
| Dode | Ndreu |
| Ed | Shkreli |
| Edi | Linadi |
| Edmond | Kacorri |
| Eduart/Aurel | Avullija |
| Elis | Bzhetaj |
| Emiljan | Zadrima |
| Fabjan | Pllumaj |
| Fatmir | Qosaj |
| Ferdinand | Grabanica |
| Flamur | Brajoviq |
| Fred | Kalaj |
| Gezim | Vushaj |
| Gezim | Lanazi |
| Gjelosh | Vushaj |
| Gjergj | Gjinaj |
| Gjergj | Nikolla |
| Gjovalin | Selmani |
| Gjovalin | Burgaj |
| Gjovalin | Melaj |
| Gjovalin | Luli |
| Ilir | Frrokaj |
| Ilir | Shyti |
| Ladi | Lumaj |
| Lec | Ndoj |
| Lec | Gashaj |
| Lek | Selmani |
| Lek | Tarazhi |
| Lek | Kapllaj |
| Leke | Koja |
| Lin | Gjerkaj |
| Luigj | Narkaj |
| Luk | Gjolaj |
| Luvigj | Lallinaj |
| Marin | Muzhani |
| Mark | Shkreli |
| Mark | Ndoci |
| Martin | Vuktilaj |
| Martin | Pjetri |
| Martin | Marashaj |
| Mhill | Ftoni |
| Mhill | Bregu |
| Mirash | Lallinaj |
| Ndue | Cacaj |
| Ndue | Selmani |
| Nik | Biqi |
| Nikolin | Vukelaj |
| Nue | Nikci |
| Nush | Kacaj |
| Pal | Rranxburgaj |
| Pal | Zogorjani |
| Paulin | Ndoj |
| Petrit | Ujkaj |
| Petrit | Ujka |
| Pjerin | Kalaj |
| Pjeter | Preka |
| Pjeter/Bep | Dreshaj |

| | |
|---|---|
| Prek | Kacaj |
| Prek | Lekaj |
| Prek | Gjonaj |
| Prek | Frani |
| Prek | Spaqi |
| Prel | Pepushaj |
| Pren | Prekaj |
| Roza | Kalaj |
| Shkelzen | Paplekaj |
| Silvan | Nerhati |
| Sokol | Ujka |
| Sokol | Dodaj |
| Sokol | Gashaj |
| Sokol | Sterbyci |
| Sokol | Vushaj |
| Sokol | Sokoli |
| Taulant / Elvis | Gjerkaj |
| Ton | Vocaj |
| Tonin | Ndoja |
| Tonin | Kastrati |
| Tot | Prekulaj |
| Valmir | Gjinaj |
| Vasel | Dreshaj |
| Viktor | Gjokaj |
| Viktor | Pleti |
| Vitor | Mernaçaj |
| Vladimir | Doda |
| Zef | Shkreli |
| Zef | Deklaj |

Zoti ua shperblefte ne te mira e ua shtofte!

## Haku Kishes 2017… E ka dhene:

| | |
|---|---|
| Kol | Pepa |
| Pjerin | Brucaj |
| Valmir | Gjinaj |

## Per Hakun e Kishes: Vini re…

Sikur eshte caktuar me vendim te shumices se anetareve **Haku Vjetor i Kishes** eshte 500 dollare dhe mund te jipet ne cash, check ose me credit card (shih faqen website misionineneteteza.com Donate Now for Blessed Mother Teresa Mission), **ne nje shume te vetme ose pjese pjese** gjate vitit. **Ata te cilet per arsye te ndryshme jane ne veshtiresi te kontaktojne drejperdrejt me famullitarin.**

## Per Fondin e ndertimit te Kishes ka dhene …

| | |
|---|---|
| Sokol Sterbyci | 10000 |
| Pjeter&Bep Dreshaj | 10000 |
| Ton Vocaj | 10000 |
| Aleks Coku | 5000 |
| Elis Bzhetaj | 5000 |
| Lec Gashaj | 5000 |
| Luigj Narkaj | 5000 |
| Luk Gjolaj | 5000 |
| Paulin Marku | 5000 |
| Anton Malaj | 4000 |
| Arben Pepa | 3000 |
| Luvigj Lallinaj | 3000 |
| Mirash Lallinaj | 3000 |
| Nik Biqi | 3000 |
| Anton Brunga | 2500 |
| Albert Berisha | 2000 |
| Aleks Dragu | 2000 |
| Altin Miri | 2000 |
| Artan Vuksani me vellezer | 2000 |
| Dritan Lumaj | 2000 |
| Edmond Ramaj | 2000 |
| Martin Vuktilaj | 2000 |
| Ndok Gjokaj | 2000 |
| Pjerin Kalaj | 2000 |
| Prek Gjonaj | 2000 |
| Shpend Pllumbaj | 2000 |
| Sokol/Petrit Ujka | 2000 |
| Tom Prekulaj | 2000 |
| Lek Selmani | 1500 |
| Ndue Selmani | 1500 |
| Anton Shelinaj | 1000 |
| Arben Therqaj | 1000 |
| Edi Linadi | 1000 |
| Erald Islami | 1000 |
| Gezim Lanazi | 1000 |
| Gjelosh Vushaj | 1000 |
| Gjergj Gjinaj | 1000 |
| Gjovalin Melaj | 1000 |
| Lek Ramaj | 1000 |
| Mark Ndoci | 1000 |
| Mhill Ftoni | 1000 |
| Ndue Kabashi | 1000 |
| Petrit Ujkaj | 1000 |
| Prek Spaqi | 1000 |
| Prel Pushaj | 1000 |
| Qamil Llashtica | 1000 |
| Shçiprim Lumi | 1000 |

| | |
|---|---|
| Sokol Noshi | 1000 |
| Arben Toma | 500 |
| Dorian Tabaku | 500 |
| Fatmir Qosaj | 500 |
| Kol Pepa | 500 |
| Lec Ndoj | 500 |
| Pal Rrasburgaj | 500 |
| Sokol Kaçaj | 500 |
| Pren Prekaj | 300 |
| Ernesto Ujka (US dollar) | 300 |

## Bashkia Lezhe e shpalli 2017-ën, vit dedikuar figurës së Skënderbeut në vigjilje të 550 vjetorit të vdekjes




Ne 549 vjetorin e përkujtimit te Heroit, Bashkia Lezhe e shpalli 2017- ën, si vit dedikuar figurës se Skënderbeut, ne vigjilje te 550 vjetorit te ndarjes se tij nga jeta ( 6 Maj 1405 - 17 Janar 1468).
Ndërsa mbetet një figure historike krenarie, në themel të jetëshkrimit të tij vazhdon të jetë Vepra e Barletit; "Historia e Skënderbeut"-"HISTORIA DE VITA ET HESTIS SCANDERBEGI EPIROTARUM PRINCIPIS", ("Historia e jetës dhe e bëmave të Skënderbeut Princit të Epirotëve") e shkruar në latinisht nga Marin Barleti, prift shkodran, u botua për herë të parë në Romë rreth viteve 1508 – 1510.
Kjo vepër monumentale historike tregon jetën dhe veprën e heroit legjendar të kombit shqiptar, Gjergj Kastriot Skënderbeut. E përkthyer pothuaj në të gjitha gjuhët europiane dhe mbas 500 vjetësh, edhe në gjuhën amtare të Barletit, shqipëruar nga Stefan I. Prifti, ajo përfaqëson ungjillin e patriotizmit shqiptar.
Një vepër historike, por e shkruar nga një dorë mjeshtri. Stili i gjallë dhe elegant me të cilin e ka shkruar Barleti, e bëjnë atë një vepër edhe me vlerë letrare. Këto vlera qëndrojnë në gjuhën e pasur dhe në figuracionin e pasur, në mjeshtërinë plastike të vizatimit të figurës së Skënderbeut, në frymën patetike dhe vrullin tronditës që përshkon tregimin, si dhe në bukurinë, gjerësinë dhe lehtësinë e frazës.
Vepra e Barletit përshkruan historinë e luftërave heroike të shqiptarëve, të udhëhequr nga Skënderbeu, kundër osmaneve. Atë e përshkon nga fillimi në fund ndjenja atdhetare, krenaria e autorit për vetitë luftarake të popullit të vet, dashuria dhe adhurimi për heroin, që i dha emrin një epoke të tërë në historinë e popullit shqiptar. Vlera më e çmuar që gjen Barleti te bashkatdhetarët e vet, është dashuria për lirinë, për trojet amtare, vendosmëria për të dhënë edhe jetën për mbrojtjen e tyre. Nuk ka gjë më të çmuar për njeriun sesa atdheu, nuk ka detyrë më të shenjtë sesa lufta për ta mbrojtur atë. Vepra u bë burim i një literature të gjerë për heroin tonë kombëtar, të shkruar në gjuhë të ndryshme të botës, që nga italishtja, spanjishtja, rusishtja, frengjishtja, greqishtja e deri në japonisht.
Fan Noli ka shkruar se vepra e Barletit "fitoi këndonjës anembanë botës dhe e bëri të pavdekshëm kujtimin e Skënderbeut në Evropë". Populllariteti i madh që gëzoi vepra shpjegohet me dy arsye: e para lidhet me subjektin që trajton, me figurën e Skënderbeut, e cila u bë e njohur dhe legjendare qysh në kohën e vet; e dyta qëndron në forcën dhe bukurinë e stilit me të cilin ajo është shkruar, një stil që të rrëmben.
Merita kryesore e Barletit si autor është se ngriti Skënderbeun nga një hero jetësor ne një hero letrar.